

KONTRTË DHURIM KUOTASH

Në Tiranë, sot, më date 06/11/2023.

DHURUESI: Znj. MAURA LINADI, me atësi Lazer dhe amësi Mirjeta, i datëlindjes 07/01/1994, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me numër personal J45107053F. Shtetas Shqipëtar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me cilësinë e zotëruesit të 100% të kapitalit të Shoqërisë "BLLOKU" sh.p.k. me NUIS M31809019E, themeluar në datën 07/06/2023, regjistruar pranë QKB më datë 09/06/2023, me seli në Tiranë, Rruga "Muhamet Gjollesha", nr.49, hyrja 2.

Dhe



PËRFITUESI: Z. Gëzim Berisha, i datëlindjes 06/07/1986, lindur në Prishtinë dhe banues në Brooklyn, New York, identifikuar me pashaportë amerikane me numër 581603966. Shtetas Ameerikan, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Kushtet paraprake që ekzistojnë

1. Rezulton se shoqëria "BLLOKU" sh.p.k. është person juridik shqipëtar regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit më datë 09/06/2023 dhe pajisur me numër identifikimi NUIS – M31809019E, me kapital themeltar 1.000 (njëmijë) lekë.
2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: *Ofrimi i shërbimit të marketingut digjital. Ndërtimi i platformave ndërvepruse.*
3. Ortak i vetëm i Shoqërisë është Z. Maura Linadi e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë totale 1.000 (njëmijë) lekë.
4. Ortaku i vetëm i Shoqërisë "BLLOKU" sh.p.k. Z. Maura Linadi ka vendosur të dhurojë 100 % (njëqind) të kapitalit të Shoqërisë që ajo zotëron, në vlerën 1000,00 (njëmijë) lekë në favor të Z. Gëzim Berisha.

Neni 1 Objekti i Kontratës

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është dhurimi i 100% (njëqind) të kapitalit të Shoqërisë, të zotëruar nga Znj. Maura Linadi me vlere 1.000,00 lekë (ALL).



Neni 2 **Çmimi i shitjes**

2.1 Palët, bien dakort që kuota prej 100% (njëqind) të kapitalit të shoqërisë do të dhurohet.

Neni 3 **Kalimi i titullit të pronësisë**

3.1 Kalimi i titullit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit të kalimit, sipas pikes 3.2 të këtij neni.

3.2 Shoqëria regjistron kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotavë ka efekt deklarativ.



3.3 Një kopje e kesaj kontrate dhurimi do të depozitohet menjëhere pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, (QKB) në mënyrë që të pasqyrohet kalimi i menjëhershëm i kuotavë në pronësi të blerësit.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e dhuruesit**

4.1 Dhuruesi mër përsipër, të njoftojë, garantojë dhe sigurojë Përfituesin se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të kësaj Kontrate, keto kuota:

- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor
- Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve.
- Dhuruesi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
- Dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj Kontrate, është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i fallsifikuar.
- Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota.
- Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve .

4.2 Dhuruesi është i detyruar të paguajë detyrimet në Shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbuloohen nga përfituesi në përpjestim me kuotat. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve te Kodit Civil.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit

5.1 Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Përfituesi do paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në Shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit etj ...

5.2 Përfituesi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

5.3 Përfituesi angazhohet të mbajë në emrin e vet kuotat që do të përfitojë nga kjo kontratë shitje kuotash.

5.4 Përfituesi pranon pa kushte se nuk do të shesë, lejë peng apo çdo formë tjetër tjetërsimi të kuotave, pa miratimin e zotëruesve të të paktën 1/2 (një të dytat) e kuotave të Shoqërisë.

5.5 Në rast miratimi të shitjes së kuotave, ato do ju ufrohen si fillim ortakëve të tjerë të shoqërisë dhe vetëm në rast refuzimi nga ana e tyre, kuotat do ju ofrohen për shitje palëve të treta.

5.6 Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë, të palëve.

Neni 6

Zgjidhja e kontratës



6.1 Palët nuk mund ta zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

6.2 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontrates i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

Neni 7.

Interpretimi i Kontrartës në tërësi

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontrartës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.



Neni 8
Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

8.1 Kjo Kontratë shitje, më objekt Shitje kuotash, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008" Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligji 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9
Njoftimet

9.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkuara në këtë Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

Neni 10
Gjuha e kontratës

10.1 Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

DHURUESI

Maura Linadi



PËRFITUESI

Gëzim Berisha

